

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Spring 4-2020

## TRAJTIMI LIGJOR I KORRUPSIONIT SI FORMË E KRIMIT TË ORGANIZUAR

Melodika Abrashi

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

---

### Recommended Citation

Abrashi, Melodika, "TRAJTIMI LIGJOR I KORRUPSIONIT SI FORMË E KRIMIT TË ORGANIZUAR" (2020). *Theses and Dissertations*. 1995.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1995>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Kolegji UBT  
Fakulteti Juridik

**TRAJTIMI LIGJOR I KORRUPSIONIT SI FORMË E KRIMIT TË  
ORGANIZUAR**

Shkalla Bachelor

Melodika Abrashi

Prill/2020

Prishtinë



Kolegji UBT  
Fakulteti Juridik

Punim Diplome  
Viti akademik 2015/2016

Melodika Abrashi

**TRAJTIMI LIGJOR I KORRUPSIONIT SI FORMË E KRIMIT TË  
ORGANIZUAR**

Mentor: Ph.D cand. Elmi Kelmendi

Prill/2020  
Prishtinë

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të  
pjeshme për Shkallën Bachelor.

## ABSTRAKT

Korrupsioni ekziston, prej që ekziston njerëzimi, në të gjitha mjediset, në të gjitha sistemet dhe regjimet e mundshme. Korrupsioni u përshtatet të gjitha situatave dhe mbijeton edhe gjatë fushatave më të organizuara kundër tij, pavarësisht shteti a është i zhvilluar a jo, ai është i pranishëm, vetëm se pasojat nga vendi në vend dallojnë, pasi krejt kjo varet nga shteti se sa bënë që ta luftojë këtë dukuri. Nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtëpërdrejt apo indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është planifikuar për t'u marrë për veten apo për një person tjetër.

Korrupsioni është i pranishëm pothuajse në të gjitha institucionet, duke përfshirë si shërbyes të thjeshtë e deri te pozitat më të larta, apo korrupsioni i nivelit të lartë. Në shoqërinë tonë nuk është diçka e re, ai ka ekzistuar, ekziston dhe do të vazhdojë të ekzistoj, por qëllimi është se si ta reduktojmë atë. Praktika tregon se edhe në vendet më të zhvilluara në botë, me organe gjyqësore të efektshme, janë të shumta betejat e humbura në përballje me këtë dukuri negative. Ndodhë kështu, sepse korrupsioni ka prirje që të rritet më shpejt, sesa dinamikat e implementuara për ta neutralizuar atë duke zënë rrënjë në trollin e gjerë të dobësive të njeriut. Ai është i llojlojshëm dhe shërbimet e tij paguhen në të gjitha format e mundshme: në para, me kundër shpërblim të ngjashëm, me dhurata-ryshfete, e të tjera.

Faza tranzitore dhe lufta e fundit në Kosovë, në mungesë të institucioneve shtetërore e pas krijimit të tyre, me mungesën e efikasitetit, me probleme të shumta sociale e ekonomike, ka bërë që korrupsioni të vazhdojë të paraqitet në të gjithë fushat e jetës dhe të bëhet kështu pengesë serioze për zhvillimin e vendit.

Ky punim shtjellon në fillim kuptimin e krimit të organizuar, masat vendore dhe ndërkombëtare që kanë fuqinë ta luftojnë krimin e organizuar dhe kështu duke treguar raportin që ka me korrupsionin. Kapitulli i tretë përfshin analizimin që i'u është bërë korrupsionit, duke treguar për historikun, përkufizimin e tij, situatën aktuale në Kosovë, sigurisht gjithmonë duke u referuar në raportet e nxjerrura nga institucionet e Kosovës dhe kështu duke përshkruar kornizën ligjore dhe institucionale që kanë për qëllim luftimin e korrupsionit.

## **MIRËNJOHJE/FALENDERIME**

*Dua të shpreh mirënjohjen time më të thellë për mentorin tim, Ph.D cand. Elmi Kelmendi, për mbështetjen e pakursyer profesionale që ky punim të finalizohet.*

*Falënderoj Familjen time, që më ka ushqyer me vlerat dhe integritetin që unë përfaqësoj sot, që më ka inkurajuar dhe përkrahur gjatë studimeve.*

*Në fund, dua të falënderoj të gjithë miqtë e mi dhe të gjithë ata që besuan tek unë.*

*Dedikim*

*Në vlerësim të sakrificës,*

*nënës sime, të cilës i përulem me nderimet më të thella!*

.

# PËRMBAJTJA

1.	HYRJA .....	1
2.	SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	2
2.1	Kuptimi dhe përkufizimi i krimit të organizuar .....	2
2.2	Raporti i krimit të organizuar me korrupsionin .....	4
2.3	Masat dhe mjetet e karakterit ndërkombëtar për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar .....	5
2.3.1	Konferencat dhe organizatat ndërkombëtare .....	7
2.4	Masat dhe mjetet për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar në Republikën e Kosovës .....	8
2.4.1	Rregulloret e UNMIK-ut që rregulluan fushën e krimit të organizuar .....	8
2.4.2	Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës .....	8
2.4.3	Disa Ligje të posaçme në fushën e luftimit dhe të parandalimit të krimit të organizuar ...	10
2.4.4	Mekanizmat institucional të RKS në luftimin e krimit të organizuar në përgjithësi .....	11
2.5	Kronologjia historike e korrupsionit .....	11
2.6	Përkufizimi i korrupsionit.....	13
2.7	Situata aktuale e korrupsionit në Kosovë .....	15
2.8	Veprat penale kundër korrupsioni sipas Kodit penal të RKS, KAPITULLI XXXIII .....	17
2.9	Korniza ligjore në luftë kundër korrupsionit.....	19
2.9.1	Legjislacioni vendor:.....	20
2.9.2	Legjislacioni ndërkombëtar.....	21
2.9.3	Organet vendore .....	23
2.9.4	Agjencia Kundër Korrupsionit .....	24
2.10	Institucionet dhe Organizatat Ndërkombëtare .....	26
3	DEKLARIMI I RPROBLEMIT.....	28
4	METODOLGJIA.....	30
5	PREZANTIM DHE ANALIZA E REZULTATEVE .....	31
6	KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME .....	34
7	REFERENCAT.....	37

## **LISTA E FIGURAVE**

Figura 1. Perceptimi i korrupsionit në Kosovë

## **LISTA E TABELAVE**

Tabela 1. Përfshin statistikat nga Gjykatat Themelore për vitin 2018 për trajtimin e rasteve të korrupsionit

Tabela 2. Përfshin statistikat nga Gjykata e Apelit për vitin 2018 për trajtimin e rasteve të korrupsionit

Tabela 3. Përfshin statistikat nga Gjykata Supreme për vitin 2018 për trajtimin e rasteve të korrupsionit

## **FJALORI I TERMAVE**

AKK – Agjencia kundër korrupsionit  
AKP - Agjencia Kosovare e Pronës  
D + - Organizata joqeveritare Demokracia Plus  
GSJP - Grupi për Studime Juridike dhe Politike  
HEUNI - Instituti European për parandalimin e krimit dhe kontrollin  
IKD - Instituti Kosovar për Drejtësi  
KDI - Kosovo Democratic Institute  
KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës  
KQZ - Komisioni Qendror Zgjedhor  
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
MAP - Ministria e Administratës Publike  
MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë  
MD - Ministria e Drejtësisë  
MF - Ministria e Financave  
MFSK - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
MSH - Ministria e Shëndetësisë  
MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
NJPMNP - Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike  
OKB – Organiza e Kombeve të Bashkuara  
OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit  
PK - Policia e Kosovës  
ZKM - Zyra e Kryeministrit  
ZPD - Zyra e prokurorit Disiplinor



## 1. HYRJA

Korrupsioni është një e keqe shoqërore dhe politike me rrënjë shumë të forta, andaj edhe lufta kundër tij është shumë e vështirë dhe e përbërë. Në botën moderne dhe në demokracinë parlamentare dhe kapitalizmin që tashmë kanë marrë karakter global, korrupsioni perceptohet si braktisje e interesit publik në emër të interesit privat. Për këtë dukuri ka përkufizime të shumta dhe të ndryshme, mirëpo me një përkufizim të përbashkët korrupsionin mund t'a definojmë si keqpërdorim i detyrës zyrtare për interesa personale, grupore, apo thyerje të rregullave dhe ligjeve për përfitime. Korrupsioni është një fenomen, veçanërisht i shteteve dhe vendeve në zhvillim si dhe karakteristikë e atyre që sapo kanë hedhur pas të shkuarën autoritare apo sistemin totalitar. *(Gashi, 2014)*

Në përgjithësi, nisur nga specifikat e zhvillimit të një vendi, edhe prezenca dhe perceptimi i korrupsionit reflektohet në përmasa dhe forma të ndryshme. Edhe në rastin e Kosovës, duke marrë për bazë të kaluarën e saj përgjatë historisë, sidomos periudhën e tranzicionit politik dhe social ka reflektuar në përballjen edhe me fenomenin e korrupsionit. Madje, sipas shumë studimeve të bëra, rezulton se Kosova radhitet ndër vendet me përmasa të larta të korrupsionit.

Korrupsioni në Kosovë nuk është perceptim, nuk është fjalë në ajër apo vrimë në ujë siç pretendon pushteti, është prezent në të gjitha nivelet e pushtetit dhe vazhdon të bllokojë progresin e shoqërisë, prandaj për luftimin e korrupsionit çdokush duhet të luajë një rol, institucionet e vendit, qeveria, parlamentarët, organet e hetuesisë e drejtësisë, institucionet e pavarura, shoqëria civile, mediat dhe vetë qytetarët e Kosovës. Sepse, korrupsioni si fenomen na lëndon të gjithëve, prandaj edhe lufta kundër tij, është përgjegjësi dhe duhet të jetë mision i përbashkët i të gjithëve.

Në këtë kuadër, duke qenë se korrupsioni ka marrë përmasa, dhe duke parë aktualitetin dhe prezencën e korrupsionit në shoqëri, kam vendosur të trajtoj në këtë punim temën: “Trajtimi ligjor i korrupsionit si formë e krimit të organizuar” me theks të veçantë në Kosovë.

## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

### 2.1 Kuptimi dhe përkufizimi i krimit të organizuar

Krimi i organizuar në aspektin teorik ka filluar të trajtohet relativisht vonë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka filluar të debatohet në vitet 60-ta të shekullit XX, ndërsa në shtetet e Evropës në vitet 80-ta. Në fazën e parë çështja e krimit të organizuar është trajtuar kryesisht në aspektin organizativ. Në fazën e mëvonshme krimi i organizuar është trajtuar në aspektin multidimensional. *(Salihu, 2014)*

Format e krimit të organizuar konsiderohen mafitë, bandat dhe grupet e tjera kriminale. Këto forma të krimit të organizuar më së shpeshti kryejnë vepra penale të rënda, si shantazhe dhe dhunë, trafikimi me drogë, trafikimi me njerëz dhe emigrantë, organizimi i prostitucionit, larje të parave, pastrim i parave, dhënie të mitos, tregëti me armë, falsifikim të parave, vrasjet me pagesë, etj. *(Salihu, 2014)*

Krimi i organizuar është dukuri komplekse dhe shqetësim mbarë botëror, për një kohë të gjatë në shtete të ndryshme, për të kanë ekzistuar konceptet dhe përkufizime të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se nuk janë bërë përpjekje për të pasur një përkufizim të njësuar për krimin e organizuar. Nevoja për ta pasur këtë përkufizim është ndier prej kohësh, pasi krimi i organizuar i ka kapërcyer kufijtë e një vendi. Ai është krim ndërkufitar, ndërshtetëror dhe ndërkombëtar. Zbulimi dhe goditja e krimit të organizuar kërkon medoemos bashkëpunim dhe operacione të përbashkëta ndërmjet shteteve dhe kjo arrihet ku ato kanë të njëjtin koncept për krimin e organizuar. *(Hysi, 2005)*

Termi “krim i organizuar” është përdorur për herë të parë në vitin 1896, në raportin vjetor të Shoqatës për Parandalimin e Krimit, në Nju-Jork. Në këtë raport ky term përdorej për veprimet e prostitucionit dhe të bixhozit, të mbrojtura nga zyrtarët publikë. Pra si fillim, krim i organizuar konsideroheshin bizneset ilegale në të cilat përfshiheshin politikanë, oficerë policie, juristë dhe vjedhës profesionistë, kur krimi i tyre ishte i organizuar. *(Latifi, 2014)*

Në përkufizimin e krimit të organizuar, si objekt i studimit të kësaj disipline shkencore, paraqiten disa vështirësi të caktuara, të cilat kanë të bëjnë me konceptin e këtij termi dhe atributet e tij. Në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës akoma vërehen debate politike e madje edhe shkencore rreth asaj se krimi i organizuar a duhet të nënkuptojë tërësi të aktiviteteve kriminale apo

ka të bëjë me personat të përfshirë në krime. Siç do të shohim në vijim, termi krim i organizuar përfshinë në vete në mënyrë kundërtënëse dy nocionet: a) furnizimi me të mira dhe shërbime ilegale dhe b) organizatën kriminale, e cila është e përfshirë në aktivitetet ilegale dhe e cila ka një strukturë mjaft mirë të organizuar. *(Gashi, 2014)*

Organizatë kriminale do të quhet organizata që ka një strukturë të përbërë nga dy ose më shumë persona, e krijuar për të vepruar gjatë një kohe të caktuar dhe që kryen krime për të cilat ligji parashikon një minimum prej të paktën 4 vjet burgim ose dënime më të rënda. *(Hysi, 2000)* Një kërkesë tjetër e rëndësishme për të qenë organizatë kriminale është që veprimet e saj të kryhen me qëllim përfitimi material ose qëllime të tjera dhe kur është rasti duke ndikuar në autoritet publik. Si krime të organizuara do të konsiderohen krimet e kryera nga grupet kriminale, të cilat përmbushin disa kushte, nga të cilat katër prej tyre duhet të ekzistojnë detyrimisht si:

- Bashkëpunimi i tre ose më shumë personave,
- Aktiviteti kriminal i tyre për një kohë të gjatë,
- Kryerja e krimeve me rrezikshmëri të theksuar,
- Ekzistimi i objektivit për përfitime ose pushtet. *(Latifi, 2014)*

Nëse nisemi nga njohuritë themelore se çdo krim ka edhe viktimën e saj, atëherë me të drejtë shtrohet pytja: Cilat janë viktimat e krimit të organizuar? Kështu p.sh., në disa aktivitete kriminale të organizuara që kanë të bëjnë me prostitucionin, trafikimin e drogave dehëse, bixhozin etj., kemi të bëjmë me blerësin dhe shitësin e këtyre shërbimeve, të cilat marrin pjesë me vullnet në këto aktivitete kriminale. Në rastet e aktiviteteve të tilla kriminale si viktimë paraqitet edhe vetë popullata e atij vendi apo shteti të caktuar. Me fjalë të tjera, si viktimë paraqiten edhe vetë qytetarët e ndërgjegjshëm që e respektojnë ligjin. *(Gashi, 2014)*

Viktimë e krimi të organizuar mund të paraqiten në disa forma, së pari duke qenë viktimë e drejtëpërdrejt e aktiviteteve kriminale të kryera nga grupet e krimit të organizuar, së dyti, llogaritet se shuma marramendëse të parave nga taksat dhe tatimet ngelin të pavjelura, e cila ka për pasojë edhe rritjen e taksave të qytetarëve të ndërgjegjshëm që e respektojnë ligjin dhe së fundi, kjo e rritë edhe koston e shpenzimeve të organeve të zbatimit të ligjit, të organeve të ndjekjes dhe të burgimit të personave të denuar. *(Gashi, 2014)*

Në kuadër dhe në sensin e nocionit të krimit të organizuar përdoren edhe këto shprehje: grup i organizuar, grup kriminal i organizuar dhe banda. *(Salihu, 2014)*

## 2.2 Raporti i krimit të organizuar me korrupsionin

Në mes të krimit të organizuar dhe korrupsionit ekzistojnë lidhje të ngushta dhe komplementare. Bile disa autorë korrupsionin e përmendin si një ndër format e krimit të organizuar. Korrupsioni ka lidhje të shumta me aktivitetet e ndryshme të grupeve të organizuara kriminale. Dominon bindja se korrupsioni në masë të madhe lehtëson kryerjen e shume formave të krimit të organizuar dhe veprimin e papenguar të organizatave kriminale. Korrupsioni mund të përkufizohet si keqpërdorim i autorizimeve publike të dhëna për qëllime të përfitimeve personale. Korrupsioni shkatërron përpjekjet kundër krimit të organizuar si dhe shërben si mjet kryesor për kryerjen e shumë formave të tjera kriminale. *(Gashi, 2014)*

Korrupsioni në Republikën e Kosovës vazhdon të jetë një ndër problemet akute, i cili po minon stabilitetin ekonomik, shtetin e së drejtës si dhe ka lëkundur edhe besimin e publikut tek institucionet e reja të krijuara pas luftës. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat dhe studimet e raporteve të ndryshme të publikuara nga organizatat vendore dhe ato ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me analizën e situatës, perceptimin publik si dhe me shkaqet dhe pasojat e dukurisë së korrupsionit. *(Gashi, 2014)*

Ai futet në veprimtaritë partiake të partive të spektrit politik kosovar, në qeverisjen qendrore dhe atë vendore, në organizata shtetërore dhe ato private. Korrupsioni është sa konkret aq edhe i ndërlikuar, pse jo edhe abstrakt në kuptimin dhe zbërthimin e tij. Në korrupsion gërshetohet e drejta me moralin, qeverisja me burokracinë, lufta për ekzistencë me veprimtarinë kriminale me qëllim pasurimi, sistemet e ndryshme politiko-shoqërore, diktaturat me demokracinë, dëshirat e popujve për rend demokratik dhe drejtësi humane me organizatat kriminale, krimin e shkeljen e ligjit, kërkesa për një jetesë më të mirë e qeverive dhe qeveritarëve. Korrupsioni nuk mund të trajtohet dhe të vështrohet ndaras nga krimi i organizuar. *(Latifi, 2013)*

### 2.3 Masat dhe mjetet e karakterit ndërkombëtar për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar

Në nivel ndërkombëtar, deri më tani, janë ndërmarrë disa nisma legjislative në fushën e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar, si dhe janë të njohura edhe disa forma të bashkëpunimit në këtë drejtim. Si aktet të rëndësishme juridike në këtë fushë konsiderohen konventat dhe dispozitat e tjera ligjore që janë aprovuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Bashkimit Evropian. Në vijim do të ndalemi shkurtimisht në paraqitjen dhe trajtimin e disa prej tyre.

*Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar*, e cila është miratuar nga OKB në vitin 2000, është një ndër konventat më të njohura në fushën e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar. Po ashtu, një vlerë të madhe kanë edhe dy protokollet shtesë të saj: *Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare*, si dhe *Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*. Kjo konventë potencon obligimin e shteteve për inkriminim e veprave penale serioze transnacionale, korrupsionin, larjen e parave dhe obstrukcion i drejtësisë, të kryera nga ana e grupit kriminal të organizuar. (OKB-General Assembly resolution 55/25, 2000)

*Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugët tokësore, ajrore dhe detare*, i cili plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ka për qëllim të parandalojnë dhe luftojë trafikun e migrantëve, si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërmjet shteteve palë për këtë qëllim, duke mbrojtur në të njëjtën kohë të drejtat e migrantëve. Ky protokoll përmban dispozita të përgjithshme, të cilat në mes tjerash përkufizojnë edhe termat e përdorura siç janë: “trafik i emigrantëve”, “kalim i paligjshëm”, “dokument i falsifikuar udhëtimi dhe identifikimi”, etj. Në te gjenden edhe dispozitat që rregullojnë bashkëpunimin dhe masat kundër trafikut të migrantëve si dhe ato që kanë të bëjnë me parandalimin, bashkëpunimin dhe masat e tjera ndërmjet shteteve me qëllim të pengimit të këtij trafikimi. (Nations, 2000)

*Protokolli mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*, i cili po ashtu plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ka disa qëllime të caktuara sic janë: a) të parandalojë dhe luftojë trafikun ndërkombëtar të personave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave dhe fëmijëve, b) të mbrojë

dhe ndihmojë viktimat e këti trafikui, duke respektuar të drejtat e tyre njerëzore, dhe c) të nxisë dhe lehtësojë bashkëpunim ndërmjet shteteve palë, me qëllim që të realizohen këto objektiva. Edhe ky protokoll përmban dispozita të cilat më për së afërmi rregullojnë mbrojtjen e personave të trafikuar si dhe dispozitat që u referohen parandalimit, bashkëpunimit dhe masave tjera në këtë fushë. (*Nations, 1998*)

*Konventa për ndëshkimin e tregtisë me njerëz dhe shfrytëzimin për prostitucion nga të tjerët e vitit 1949*, me këtë konventë palët nënshkruese obligohen që të dënojnë të gjitha format e tregtisë me genie njerëzore për qëllime të prostitucionit përmes nxjerrjes së akteve ligjore në këtë fushë si dhe të formave të ndryshme të bashkëpunimit të ndërsjellë. (*Assembly, 1949*)

*Konventa e vetme mbi drogat narkotike (1961) e ndryshuar nga Protokollin e vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së vetme mbi drogat narkotike (1961)*, me të cilën konventë palët nënshkruese marrin obligime që t'i zbatojnë dispozitat e kësaj konvente si dhe të kufizojnë vetëm për qëllime mjekësore dhe shkencore prodhimin, fabrikimin, eksportin, importin, shpërndarjen, tregtimin dhe zotërimin e drogave. (*Assembly, 1949*)

*Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1988 "Kundër trafikut të paligjshëm të drogave dehëse dhe lëndëve psikotrope" ose "Konventa e Vjenës"*, qëllimi i kësaj konvente është që të nxisë bashkëpunimin midis palëve në mënyrë që ato të mund t'i trajtojnë në mënyrë më të efekshme aspektet e ndryshme të trafikut të paligjshëm të drogave dehëse dhe lëndëve psikotrope. Kjo konventë obligon palët që të marrin masat e nevojshme, përfshirë masat legjislative dhe administrative në këtë fushë. Po ashtu me këtë konventë parashikohet sekuestrimi i fitimeve që rrjedhin nga kjo formë e krimit të organizuar, ekstradimi dhe asistenca e ndërsjellë ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit etj. (*Assembly, 1988*)

*Protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentë dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar*, është nxjerrë në vitin 2001, qëllimi i këtij protokollin është të nxisë, lehtësojë dhe forcojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare, me qëllim parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve. (*Assembly, 2001*)

*Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në vitin 2005, qëllimet e saj janë: a) parandalimi dhe lufta e trafikimit të qenieve njerëzore, duke garantuar barazinë gjinore, b) mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit, ndërtimi i një kuadri gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, duke garantuar barazi gjinore, si dhe duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive, c) si dhe nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore. (Europe, 2005)*

*Konventa e Evropolit për krimin e organizuar me të cilën evidentohen 11 karakteristika të krimit të organizuar të adaptuara nga Europoli. (Gashi, 2014)*

*Konventa e Këshillit të Evropës për pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit, e cila është nxjerrë më 2005 në Varshavë. (Community, 2005)*

### 2.3.1 Konferencat dhe organizatat ndërkombëtare

Lidhur me krimin e organizuar dhe parandalimin e tij janë mbajtur edhe shumë konferenca dhe seminare ndërkombëtare, në të cilat janë trajtuar tema me rëndësi të kësaj fushe. Ku nga këto konferenca janë miratuar akte me rëndësi të madhe. Në fushën e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar në nivel evropian, mund të thuhet se një kontribut të madh kanë dhënë dy organizata ndërkombëtare: Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Ato kanë hartuar disa orientime themelore të politikës evropiane të vendeve anëtare të BE-së. Këshillimi i Evropës ka edhe një varg institutesh që kontribuojnë në luftimin e krimit të organizuar siç janë: Instituti Evropian për parandalimin e krimit dhe kontrollin (HEUNI), Qendra e përbashkët e kërkimit për krimin transnacional, Qendra për informimin dhe studimin e krimit të organizuar e të tjera.

Nxjerrja e këtyre konventave dhe akteve të tjera juridike ndërkombëtare si dhe mbajtja e seminareve dhe konferencave të ndryshme në nivel ndërkombëtar dhe rajonal kanë dhënë kontribut të çmuar në fushën e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar, si dhe ato janë një ndihmesë e madhe për shtetet e ndryshme të shoqërisë bashkëkohore në unifikimin e politikave ligjore dhe kriminale në këtë fushë. (Gashi, 2014)

## 2.4 Masat dhe mjetet për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar në Republikën e Kosovës

Në Republikën e Kosovës janë nxjerrë disa akte juridike të cilat janë në funksion të luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar. Deri vonë, në masë të paktë, fusha e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar është rregulluar me disa rregullore të UNMIK-ut. Në vijim vetëm do t'i përmendi ato të cilat kanë ndihmuar në luftimin e kësaj dukurie, e më tej do të ndalem më shumë në ligjet aktuale që kanë për qëllim luftimin e korrupsionit.

### 2.4.1 Rregulloret e UNMIK-ut që rregulluan fushën e krimit të organizuar

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vendosjes së saj nën Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara, Kosova është ndeshur me një vakum ligjor dhe institucional, pasi që ajo nuk kishte ligje vatanake. Si rezultat i krijimit të një realiteti të ri juridiko-politik, dhe me qëllim të plotësimit të zbrasëtirës juridike, UNMIK-u ka filluar të nxjerrë akte juridike përkatëse në formë të rregulloreve të cilat kanë rregulluar fusha të caktuara të jetës dhe marrëdhënieve shoqërore.

Ndër aktet e para juridike që janë nxjerrë në këtë fushë konsiderohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/22 “Mbi masat kundër kriminalitetit të organizuar”, “ Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë” nr. 2001/4, “Mbi masat e fshehta dhe masat teknike të vëzhgimit dhe hetimit” nr. 2002/6, “Mbi dëshmitarët bashkëpunues” nr. 2001/21, “Mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale” nr. 2004/2, “Për mbrojtje kundër rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve” nr. 2004/29, e të tjera. (*Gashi, 2014*)

### 2.4.2 Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

Këto dy kode për herë të parë kanë hyrë në fuqi më 6 Korrik të vitit 2003, kurse aktualisht janë në zbatim po të njëjtat me vetëm me disa ndryshime që kanë ndodhur gjatë viteve. (*Gashi, 2014*) Kodi penal i Kosovës, përpos dispozitave të pjesës së përgjithshme që kanë të bëjnë me bashkëpunimin në kryerjen e veprave penale, përmban edhe disa dispozita të posaçme lidhur me



krimin e organizuar dhe format e tij. Këto dispozita janë parashikuar në Nenin 31 të këtij Kodi. Me kodin penal rregullohet njëherazi edhe çështjet e përgjegjësisë dhe e dënimit të anëtarëve të cilët janë bashkuar për të kryer veprime penale.

Në pjesën e veçantë të Kodit penal të Kosovës janë përfshirë një numër i madh i dispozitave që kanë të bëjnë me veprat penale të cilat mund të kryhen në mënyrë të organizuar. Në këtë kod, në kuadër të kapitullit ku bëhet fjalë për vepra penale kundër pasurisë, është parashikuar gjithashtu edhe një vepër e veçantë që quhet *Krimi i Organizuar* (Kapitulli XXIV “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”, neni 277). Me këtë nen rregullohet çështje të caktuara që kanë të bëjnë me mënyrat e kryerjes së krimit të organizuar dhe me masat që mund t’u shqiptohen kryrësve të një vepre penale të rëndë, si pjesë e një grupi të organizuar kriminal, si dhe dënimet që mund t’u shqiptohen edhe personave të tjerë të cilët paraqiten në cilësi të pjesëmarrësit aktiv në ndërmartjen e aktiviteteve kriminale të grupit kriminal të organizuar. (*Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2019*)

Në pjesën e veçantë të Kodit penal të Kosovës ka edhe dispozita të tjera që kanë të bëjnë me lloje të ndryshme të veprave penale të cilat kryhen në mënyrë të organizuar . Kështu për shembull: Me nenin 164 vepër penale konsiderohet *Kontrabandimi me emigrantë*, neni 165 vepra penale *Trafikimi me njerëz*. (*Beka, 2015*) Po ashtu, Kodi ynë penal përmban edhe dispozita të tjera në pjesën e posaçme që kanë të bëjnë me veprat penale që kryhen në forma të organizuara siç janë: *në fushën e veprave penale të narkotikëve, të veprave penale kundër ekonomisë* ( organizimi i skemave piramidale të bixhozit të paligjshëm, falsifikimi i parasë, shpërlarja e parave, kontrabandimi i mallrave, e të tjera), *të veprave penale kundër pasurisë* (p.sh vjedhja e rëndë, grabitja, detyrimi, shantazhi, fajdeja, e të tjera), *veprat penale të armëve, etj.* (*Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2019*)

Edhe me dispozitat e Kodit të procedurë penale të Kosovës janë aprovuar disa standarte dhe zgjidhje bashkëkohore që kanë të bëjnë me shtimin e efikasitetit të procedurës penale ndaj organizatorëve dhe kryrësve të formave të krimit të organizuar. Në këtë drejtim vlen të përmendet dispozitat që kanë të bëjnë me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, të mbrojtjes së dëshmitarëve, të dëshmitarëve bashkëpunues etj. Në rastet kur kemi të bëjmë me format e rënda të kriminalitetit e veçmas të atij të organizuar, në mënyrë që të luftohet dhe parandalohet me sukses kjo formë e rrezikshme e kriminalitetit. (*Kuvendi i Republike se Kosovës, 2012*)

Kësisoj, në nenin 87 të Kodit të procedurës penale të Kosovës janë paraparë masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, siç janë: 1. vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, 2. Monitorimi i fshehtë i bisedave, 3. Kontrollimi i dërgesave postare, 4. Përgjimi i telekomunikimeve, 5. Përgjimi i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, 6. Dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, 7. Shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, 8. Blerje e simuluar e ndonjë sendi, 9. Simulimi i veprës së korrupsionit, 10. Hetimi i fshehtë, 11. Regjistrimi i thirrjeve telefonike dhe 12. Zbulimi i të dhënave financiare. (Gashi, 2014)

#### 2.4.3 Disa Ligje të posaçme në fushën e luftimit dhe të parandalimit të krimit të organizuar

Në Republikën e Kosovës janë miratuar edhe disa ligje të posaçme në fushën e luftimit dhe parandalimit të disa formave të krimit të organizuar. Kosova ka në fuqi një bazë të gjerë të legjisllacionit ku, si legjisllacion parësor mund të përmenden, por nuk kufizohet vetëm tek:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ;
2. Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat ;
3. Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit ;
4. Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ;
5. Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ;
6. Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës ;
7. Ligji nr. 04/-L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve ;
8. Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur ;
9. Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale ;
10. Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit ;
11. Ligji nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë ;
12. Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (Qeveria/Ministria e Punëve të Brendshme, 2019)

#### 2.4.4 Mekanizmat institucional të RKS në luftimin e krimit të organizuar në përgjithësi

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi në koordinimin e aktiviteteve në luftë kundër krimit të organizuar. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar në Republikën e Kosovës, detyrë dhe përgjegjësi kanë këto institucione:

1. Ministria e Punëve të Brendshme
2. Koordinatori Nacional Kundër Krimit të Organizuar
3. Policia e Kosovës
4. Ministria e Financave
5. Dogana e Kosovës
6. Ministria e Drejtësisë
7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës
8. Këshilli Prokurorial i Kosovës
9. Prokurori i Shtetit
10. Gjykatat
11. Agjencia kundër Korrupsionit

Në kuadrin institucional, një rol të rëndësishëm për parandalim dhe luftim të krimit të organizuar luajnë edhe institucionet tjera vendore dhe institucionet ndërkombëtare, partnerë prezentë në Kosovë, por edhe jashtë saj. (*Qeveria/Ministria e Punëve të Brendshme, 2019*)

#### 2.5 Kronologjia historike e korrupsionit

Korrupsioni përbën një fenomen global të kahershëm. Termi korrupsion i ka fillimet në vitet 1250-1300, nga latinishtja rumpere, që do të thotë të thyesh, në përputhje me këtë korrupsioni ndodh aty ku shkelet ligji. (*Halili, 2016*) Kjo kërkon që të gjithë ligjet të jenë të qarta, të mos ketë dyshime për kuptimin e tyre dhe zbatimin të mos jetë diskrecion i zyrtarit publik. Një interpretim ligjor i korrupsionit ofron një kufi të qartë midis asaj që është e korruptuar dhe asaj që nuk është e korruptuar, nëse një vepër e zyrtarit është e ndaluar nga ligjet e vendosura, ajo është e korruptuar. Robert Klitegard arsyetonte se korrupsioni i ka fillimet në jetën shoqërore të organizuar dhe është po aq i vjetër sa qeverisja, ndërsa Daniel Kaufman dhe Vito Tanzi i lidhin fillimet e korrupsionit me tekstin indian The Arthashastra, 2400 vjet më parë, në të cilin korrupsioni trajtohet si i paevitueshëm. Studiues të tjerë, jo vetëm njohin ekzistencën e korrupsionit të hershëm në histori,

por njohin edhe pasojat e tij. Mac Mullen (1988) argumenton që korrupsioni ishte një nga shkaqet e rënies së Perandorisë Romake. *(Halili, 2016)*

Interesi akademik mbi korrupsionin dhe efektet e tij ka nisur në vitet 1950-1960, veçanërisht ky interes është intensifikuar në vitet 1990 me Rënien e Bashkimit Sovjetik, si dhe me interesin ndërkombëtar mbi efektet shkatërruese të korrupsionit, për të mbërritur në dekadën e fundit të shekullit XX. *(Halili, 2016)*

Më 1992, Këshilli i Evropës krijoi një “Grup ndërdisiplinor mbi korrupsionin, duke zyrtarizuar kështu risinë e korrupsionit si një çështje publike që ka nevojë për rregullime të posaçme. *(Europe, 2016)* Që atëherë, pasuan edhe mjaft organizma të tjerë ndërkombëtar. Kështu, më 1998, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore e shpallën luftën kundër korrupsionit një ndër kriteret e reja për një administrim të mirë ekonomik. *(Lascoumes, 2002)*

Për herë të parë juridikisht korrupsioni është parashikuar si vepër penale me Ligjin Penal të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1974. Ndërsa, pas luftës së fundit në Kosovë, në vitin 2004 është miratuar Ligji kundër korrupsionit, gjegjësisht në kapitullin e njëzet e nëntë, në veprat penale kundër detyrës zyrtare. *(Halili, 2016)*

Ky kapitull ka trajtuar gjithsej 13 forma dhe lloje të shfaqjes së korrupsionit në Kosovë, duke përfshirë këto vepra:

1. Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit;
2. Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës;
3. Mashtrimi në detyrë;
4. Përdorimi i paautorizuar i pasurisë;
5. Marrja e ryshfetit;
6. Dhënia e ryshfetit;
7. Ushtrimi i ndikimit;
8. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore;
9. Zbulimi i fshehtësive zyrtare;
10. Falsifikimi i dokumenteve zyrtare;
11. Arkëtimi dhe pagesa e paligjshme;
12. Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria;

13. Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit Gjyqësor. (*Kuveni i Kosovës, 2003*)

Por më pas duke përfunduar me ndryshimet e fundit në Kodin Penal të Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 14 Janar të vitit 2019, Kod i cili përmban një kapitull të veçantë dhe në të trajton veprat penale në lidhje me korrupsionin zyrtar dhe kryerjen e detyrave zyrtare në kapitullin 33 në gjithsej 17 vepra të tilla. (Neni 414-Neni 430) (*Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2019*)

## 2.6 Përkufizimi i korrupsionit

Fjala korrupsion ka prejardhje latine dhe një kuptim të gjerë. Rjedh nga fjala: "Corruptus" dhe kuptimi i saj në shqip mund të jepet si 'prishje e plotë' e diçkaje degradim etj. Në jetën e përditshme ajo po përdoret aq shumë sa që tanimë tingëllon gati si emërtim simpatik, edhe pse kuptimi i saj i mirëfilltë në thelb do të thotë: ndyrje, fëlliqje, shkatërrim. Për korrupsionin ka përkufizime të shumta dhe të ndryshme por pothuajse me një përkufizim të përbashkët korrupsionin mund ta definojmë si keqpërdorim i detyrës zyrtare për interesa personale, grupore, apo thyerje të rregullave dhe ligjeve për përfitime. (*Halili, 2016*)

Dukurinë e këtij fenomeni mund t'a analizojmë në këndvështrimin ligjor ku korrupsioni përkufizohet jo vetëm si vepër penale për të cilën parashikohet dënimi, por edhe si shkelje e rendit ligjor në një vend. Në këndvështrimin ekonomik, konsiderohet si dukuri shkatërruese ndaj parimeve të ekonomisë dhe ligjshmërisë në përgjithësi, ndërsa në këndvështrimin politik paraqet rrezikun për funksionimin e mirëfilltë të shtetit dhe të së drejtës dhe të interesit të përgjithshëm. Organizata e Kombeve të Bashkuara, dukurinë e korrupsionit e shpjegon si dukuri që minon institucionet demokratike, ngadalëson zhvillimin ekonomik dhe i bën qeveritë më pak të qëndrueshme, ndërsa Banka Botërore e ka përcaktuar korrupsionin si një ndër pengesat më kryesore të zhvillimit ekonomik pasi prezenca e tij i zë frymën e konkurrencës së lirë. (*Parliamentary Assembly, 2016*)

Sipas Transparency International - korrupsioni konsiston në abuzimin e një pushteti, të fituar përmes delegimit, për qëllime private. Ky përkufizim vë në dukje tre elementë përbërës të korrupsionit:

1. Abuzimin e pushtetit;
2. Qëllime private, që do të thotë se nuk përfiton vetëm abuzuesi i pushtetit, por përfshihen gjithashtu anëtarët e afërt të familjes ose miqtë e tij;
3. Pushtet i fituar prej delegimit, që do të thotë se mundet të burojnë si prej sektorit publik ashtu edhe prej sektorit privat. (*Anti-Corruption, n.d.*)

Asambleja parlamentare e Këshillit të Evropës e përcakton korrupsionin si “përdorimin dhe abuzimin e pushtetit publik për qëllime private”. Korrupsioni është vjedhje. Ai gjithashtu rrënon institucionet publike, minon sundimin e ligjit dhe degradon besimin e qytetarëve në sistemin politik. (*PACE, n.d.*)

Për Komisionin Evropian, “korrupsioni është i lidhur me çdo abuzim të pushtetit dhe çdo parregullsi të kryer në një proces vendimarrje, në shkëmbim të një nxitje ose një avantazhi të padrejtë.” Korrupsioni është një nga krimet veçanërisht të rënda, me një dimension ndërkuftar. Shpeshherë, ai është i ndërlidhur me forma të tjera të krimeve të rënda, të tilla siç janë trafikimi me qenie njerëzore, trafikimi i drogës, dhe se ky fenomen nuk mund të trajtohet në mënyrë adekuate vetëm nga shtetet e BE-së. (*Commission, 2016*)

Në renditjen globale të indeksit, në lidhje me perceptimin e korrupsionit në vendet e Evropës dhe Ballkanit Perëndimor, Kosova renditet në një pozitë të pafavorshme me 36 pikë dhe tani renditet në vendin e 93 nga gjithsej 176 shtete. (*Anti-Corruption, n.d.*) Prandaj është në interes të Kosovës që të përmirësojë imazhin e saj në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit.

Parandalimi dhe lufta e korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, siç janë Konventat e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës, Konventa Civile e kundër Korrupsionit Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera kundër korrupsionit.

Përkundër përparimit të arritur deri më tani, Kosova si vendet e tjera në rajon, vazhdon të përballet me vështirësi në sektorin e Sundimit të Ligjit, respektivisht me mangësitë në sistemin gjyqësor, çështjet e brendshme dhe qasjen në drejtësi. Raportet e ndryshme ndërkombëtare (Dokumentet Teknike të Projektit kundër Krimeve Ekonomike në Kosovë (PECK II) dhe Raportet e Progresit

për Kosovën nga Komisioni Evropian) dhe dokumentet strategjike kombëtare nxjerrin në pah nevojën për angazhim proaktiv të shtetit në përmirësimin e efikasitetit të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit në përgjithësi, veçanërisht në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. (*Qeveria/Ministria e Punëve të Brendshme, 2019*)

Bazuar në të dhënat nga raporti vjetor, vërehet se përpjekjet e përbashkëta të sistemit të drejtësisë dhe mekanizmave të tjerë janë të nevojshëm për të luftuar korrupsionin në mënyrë që të ndërtohet një sistem i fortë institucional që prodhon rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe përfundimisht krijon dhe rrit besimin tek qytetarët. Pavarësisht nga kjo vetëdije politike dhe sociale, me qëllimin përfundimtar të modernizimit të qeverisjes në vend, Kosova është e përkushtuar ndaj luftës së pa kompromis kundër korrupsionit me zero tolerancë, duke i dhënë kësaj politike publike përparësinë që meriton.

Ndonëse është bërë progres në luftimin e korrupsionit, ajo vazhdon të jetë një shqetësim për institucionet e Republikës së Kosovës. Me gjithë angazhimet për krijimin e një mjedisi të lirë social nga ndikimi i korrupsionit, rezultatet ende nuk mund të konsiderohen të kënaqshme. Autoritetet e Kosovës kanë përcaktuar përparësi të qarta për zbatimin e legjislacionit që synon luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit institucional. (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

## 2.7 Situata aktuale e korrupsionit në Kosovë

Që nga pavarësia e Kosovës, lufta kundër korrupsionit ka qenë ndër prioritetet e bashkësisë ndërkombëtare dhe së fundmi edhe të qeverisë kosovare. Kosova karakterizohet nga nivele të larta të korrupsionit, edhe pse lufta kundër korrupsionit është vendosur në krye të agjendave të partive politike në pushtet. Teksa Kosova ka treguar përkushtim ndaj luftës kundër korrupsionit duke miratuar një numër ligjesh, rregullash dhe strategjish, këto nisma kanë pasur ndikim të kufizuar në luftimin e këtij fenomeni. (*Brooks, 2019*)

Tipari themelor i luftës kundër korrupsionit në Kosovë në vitet e fundit është fakti se përmirësimet kanë qenë të pakënaqshme. Sipas disa perceptimeve ndërkombëtare dhe lokale dhe studimeve faktike, janë bërë shumë pak ndryshime. Niveli i korrupsionit ende është shqetësues në Kosovë.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare (IPK) (*Anti-Corruption, n.d.*) nuk ka pasur zhvillime pozitive që nga viti 2012: atë vit IPK ishte 34 , pastaj ra në 33 në tre vitet e ardhshme, pastaj dhe është rritur ndjeshëm në 36 në vitin 2016, dhe së fundmi Kosova u radhit e 93-ta me 37 pikë, në krahasim me vitin që e lamë pas që ishte në vendin e 85-të me 39 pikë. (Me 1 është i keq dhe 100 rezultati më i mirë) Cka tregon se sektori publik në Kosovë perceptohet se është shumë i korruptuar dhe sugjeron që korrupsioni është thellësisht i rrënjosur në sferat ekonomike, sociale dhe politike.

Ajo se cka u tha në këtë raport ishte se disa nga sfidat më të mëdha anti-korrupsion në Kosovë përfshijnë transparencën e pamjaftueshme, institucione dhe sundim të ligjit të dobët dhe hapësirë të pamjaftueshme për angazhimin e qytetarëve. Sipas deputetëve të Kuvendit të Kosovës, rezultatet e dala nga ky raport janë reflektim i gjendjes aktuale në vend. Kurse sipas kreut të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, korrupsioni nuk është luftuar gjatë vitit 2018. E për qytetarët kjo gjë është shqetësuese, ngase nuk po shohin të ardhme të mirë në Kosovë. (*International-Kosova, 2018*)

Nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, përkeqësim në luftën kundër korrupsionit kanë shënuar shumica e tyre.

Shqipëria ka zbritur në pozitën 99, nga 91 sa ka qenë një vit më herët. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak të një ngërçi politik që ka bllokuar disa reforma anti-korrupsion që të ecin përpara.


Serbia ka rënë nga pozita 77 në pozitën 87. Trendi i rënies, sipas Transparency International, mund të vazhdojë, nëse Qeveria e Serbisë vazhdon t'i minojë ato organe dhe institucione që janë përgjegjëse për sundimin e ligjit.

Mali i Zi po ashtu ka rënë nga pozita 64 në 67. Në një mjedis të dominuar nga elita e njëjtë udhëheqëse për më shumë se dy dekada, efektet e kapjes së shtetit janë të dukshme në Mal të Zi.

Maqedonia ka shënuar përparim, duke u radhitur në pozitën 93 nga 107 sa ka qenë vitin paraprak. Organizata thotë se pritjet anti-korrupsion në këtë vend, që është i interesuar për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, janë ta larta.



Përparim të lehtë ka edhe në Bosnje e Hercegovinë, e cila ka qenë në vendin 91, ndërsa është në vendin 89, porse numri i saj i pikëve mbetet i pandryshuar: Sipas Transparency International, zhvillimet politike në këtë vend janë shqetësuese.



**Figura 1. Perceptimi i korrupsionit në Kosovë** (Susuri, 2019)

## 2.8 Veprat penale kundër korrupsionit sipas Kodit penal të RKS, KAPITULLI XXXIII

Dukuria e keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimeve zyrtare dhe në përgjithësi, veprimi i kundërligjshëm i personave zyrtarë, veçanërisht korrupsionit, janë të njohura dhe të inkriminuara kaherë në të drejtën penale. Mirëpo sistematizimi në të ashtuquajturat vepra penale zyrtare dhe radhitja e tyre në grupe të posaçme, ka ndodhur mjaft vonë, më saktë në legjislacionin penal të shekullit XIX. Prej atëherë ka filluar edhe përpunimi i rëndësishëm teorik i këtyre veprave penale.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare përbëjnë sjellje të kundërligjshme të drejtuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, të cilat i kryejnë personat e autorizuar apo personat

zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare ose lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare. Kjo formë e kryerjes së veprës penale sot bie në kategorinë e kriminalitetit me shkallë të lartë rreziku për shoqërinë. Kjo gjë manifestohet jo vetëm në pasojat materiale që rezultojnë nga kryerja e këtyre veprave penale, por sidomos në rrënimin dhe çrregullimin e rrjedhave themelore të jetës shoqërore, duke atakuar vlerat morale të shoqërisë. Karakteristikë themelore e këtyre veprave penale e përbën pikërisht cenimi i detyrës zyrtare. (Hasani, 2014)

Një nga elementet themelore të përbashkëta të veprave penale të Kapitullit XXXIII, është edhe ai që kryes i saj, në numrin më të madh të rasteve, mund të jetë vetëm personi zyrtar. Mirëpo personi zyrtar, si subjekt kryesor i këtyre veprave penale përcakton vetvetiu karakterin e tyre për t'u radhitur në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare. Kryesit e veprave penale të korrupsionit rëndom nuk janë nga radhët e kriminalitetit klasik, po janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona me pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse, në afarizmin komercial, ekonomik, doganor, etj. (Hasani, 2014)

Veprat penale të Kapitullit XXXIII janë: (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2019)

**Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar**

**Neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik**

**Neni 416 Keqpërdorimi i informatës zyrtare**

**Neni 417 Konflikti i interesit**

**Neni 418 Përvetësimi në detyrë**

**Neni 419 Mashtrimi në detyrë**

**Neni 420 Përdorimi i paautorizuar i pasurisë**

**Neni 421 Marrja e ryshfetit**

**Neni 422 Dhënia e ryshfetit**

**Neni 423 Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar**

**Neni 424 Ushtrimi i ndikimit**

**Neni 425 Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore**

**Neni 426 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare**

**Neni 427 Falsifikimi i dokumentit zyrtar**

**Neni 428 Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme**

**Neni 429 Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor**

**Neni 430 Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare**

## 2.9 Korniza ligjore në luftë kundër korrupsionit

Politikat dhe iniciativat kundër korrupsionit kanë qenë fokus i përpjekjeve juridike dhe institucionale që janë ndërmarrë viteve të fundit në Kosovë. Në këtë vazhde, është vërejtur një përparim në trajtimin e sfidave të korrupsionit nga palët e interesuara, kryesisht përmes fillimit të adresimit të disa rasteve korruptive dhe përmirësimit të kornizës dhe strukturave legjislativë ekzistuese për ta trajtuar korrupsionin. Megjithatë, përhapja e korrupsionit në shumë fusha, perceptimi shumë negativ drejt pranisë së tij të gjerë, niveli ende i pakompletuar i kornizës legjislativë, përpjekjet e pamjaftueshme për trajtimin e kësaj sfide në mënyrë më proaktive, në veçanti përmes zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit, janë theksuar si mangësitë kyçe.

Strategjia kundër korrupsionit dhe plani i veprimit për zbatimin e saj janë miratuar vazhdimisht në cikle prej 3-4 viteve që nga viti 2004. Përmes pranimit të vullnetit politik si parakusht kyç për zbatimin e objektivave të saj, por edhe përmes përdorimit të një qasje gjithëpërfshirëse për zbatimin e masave kundër korrupsionit për një varg të gjerë të organeve shtetërore, mediave dhe shoqërisë civile, në vitin 2011 AKK-ja e ka hartuar një kornizë të re strategjike. Duke u bazuar fillimisht në një vlerësim të ciklit strategjik të mëparshëm (2009-2011), si dhe për ta rifuqizuar llogaridhënien e institucioneve përgjegjëse, një pako e re e dokumenteve po ashtu për herë të parë është bazuar në vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni dhe në një kornizë të vlerësimit. Në janar të vitit 2012, Qeveria e Kosovës e miratoi Strategjinë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2012-2016, dhe e dërgoi atë në Kuvendin e Kosovës për miratim përfundimtar. Megjithatë, në prill të vitit 2012, përmes një vote negative, Kuvendi e ktheu dokumentin strategjik prapë tek Qeveria për shqyrtim. Pas disa rregullimesh (mes të tjerash për caktimin e një date të re

të vlefshmërisë: 2013-2017), Qeveria e rimiratoi tekstin e Strategjisë dhe të planit të veprimit dhe e ridërgoi në Kuvend.

Zbatimi i strategjisë kundër korrupsionit në nivelin qendror dhe atë lokal monitorohet prej Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit (AKK). Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave i raportojnë AKK-së çdo gjashtë muaj si dhe sipas nevojës, ndërsa AKK-ja e dërgon një raport vjetor në Kuvend. Në Zyrën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë është caktuar një prokuror për t'u marrë ekskluzivisht me rastet e korrupsionit. (*Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2010*)

Ekipi i Vlerësimit e merr me kënaqësi faktin se Kosova ka filluar një debat ndër institucional rreth korrupsionit dhe ka ndërmarrë, qe disa vite me radhë, masa të ndryshme në nivel të politikave, në nivel juridik dhe institucional për trajtimin e sfidës së korrupsionit të përhapur. Janë vërejtur zhvillime të ndryshme për ta përshtatur legjislacionin me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare kundër korrupsionit.

Megjithatë, propozimi strategjia dhe plani i veprimit kundër korrupsionit, pas miratimit të tyre nga Qeveria në fillim të vitit 2012, nuk janë miratuar me shpejtësi prej Kuvendit. Pasi që Kuvendi i ktheu këto dokumente strategjike në Qeveri në prill 2012, shqyrtimi i tyre i mëtejshëm zgjati për disa muaj dhe nuk doli me asnjë rezultat. Paksa të shqyrtuara, këto dokumente janë miratuar përsëri prej Qeverisë në nëntor të vitit 2012, dhe përfundimisht prej Kuvendit më 11 shkurt 2013. (Agjencia kunder korrupsionit, 2013) Tani aktualisht i referohemi Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit 2019-2023. (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

Korniza ligjore bazë në të cilin Agjencia ushtron mandatin e saj ligjor janë aktet e mëposhtme, por jo të kufizuara vetëm në:

#### 2.9.1 Legjislacioni vendor:

##### **Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit**

Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e AKK-së në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit. (*Kosoves, 2010*)

**Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë dhe Ligjin nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L-050**

Ky ligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për të deklaruar pronën, të ardhurat dhe origjinën e tyre, detyrën e AKK-së për të kontrolluar deklarin dhe kontrollin e pasurisë, si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe origjinën e tyre. (*Kosoves, 2011*)

**Ligji nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik**

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit të interesit në interesin publik dhe privat të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksioneve publike. (*Kosoves, 2018*)

2.9.2 Legjislacioni ndërkombëtar

Këto instrumente të cilat janë të përmendura luajn rolë në luftimin e korrupsionit, ku do të japë përkufizimin juridik të korrupsionit sipas akteve ndërkombëtare.

**Konventa Penale për Korrupsionin** në nenet 2 dhe 3 jep përkufizimin e korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve kombëtarë. Në tekstin e saj përsa i përket përfitimit, ajo e cilëson si përfitim që nuk i takon zyrtarit publik. Kjo konventë përcakton rrethin e subjekteve aktivë të veprave penale të korrupsionit, si dhe figurat e veprave penale të tilla, si ushtrimi i ndikimit (neni 12), pastrimi i parave të produkteve nga veprat e korrupsionit (neni 13), veprat e llogarive (neni 14). (*Konventa Penale e Korrupsionit e Këshillit të Evropës (Nr. 173, 1999)*)

Një tjetër konventë, **Konventa Civile mbi korrupsionin**, roli themelor i së cilës qëndron në njohjen e pasojave të dëmshme financiare të korrupsionit ndaj individëve, kompanive dhe shteteve si dhe veçanërisht në parashikimin e kompesimit të drejtë për personat e dëmtuar nga korrupsioni nëpërmjet procedurave dhe mekanizmave të legjislacionit penal e përcakton korrupsionin (neni 2) si : “Kërkimi, ofrimi, dhënia ose pranimi drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë të një mitmarrje ose të çdo lloj avantazhi ose përfitimi që deformon kryerjen e çdo detyre ose sjellje të pranuar nga

kërkuesi i mitmarrjes për pasojë dhe të avantazhit ose përfitimit të padrejtë.” (*Konventa Civile kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës (Nr.174, 1999)*)

**Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Korrupsionin** e vitit 2003, në disa nene (neni 5 dhe 8) e lidh korrupsionin drejtpërsëdrejtë me integritetin. Neni 5/1 sanksionon: “Secili shtet palë, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor të tij, zhvillon dhe zbaton ose ruan politika të efektshme dhe të koordinuara kundër korrupsionit që nxisin pjesëmarrjen e shoqërisë dhe reflektojnë parimet e shtetit ligjor, administrimin e rregullt të punëve publike, pasurisë publike, integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë.” Neni 8/1 sanksionon: “Me qëllim që, të luftohet korrupsioni, secili shtet palë nxit, ndërmjet të tjerash, integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjësinë e nëpunësve të tij publikë, në përputhje me principet themelore të sistemit të tij ligjor.” Sipas nenit 15 të kësaj konvente, ryshfeti përkufizohet si: “Premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër apo subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij/të saj zyrtare. Kërkimi ose pranimi nga nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër, apo një subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare.” Kjo konventë në nenet 15 (dhënia e ryshfetit nëpunësve publikë), neni 16 (dhënia e ryshfetit nëpunësve publikë të huaj dhe nëpunësve të organizatave publike ndërkombëtare), neni 17 (trafikimi i influencave), neni 18 (abuzimi me funksionet), neni 19, neni 20 (pasurimi i paligjshëm) sanksionon disa forma të shfaqjes së korrupsionit në sektorin publik duke u shndërruar në një tregues të rëndësishëm të kompleksitetit dhe larmishmërisë së veprave penale të korrupsionit. (*Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (58/4, 2003)*)

Dhe të tjera sic janë “**Protokolli i Dytë i Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve**”, “**Protokolli i Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane**”, “**Konventa e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim për Luftimin e Korrupsionit**”, “**Protokolli Shtesë i Konventës Penale kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës**”. (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

### **3.6 Institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare në luftimin e korrupsionit**

Integriteti përfshin sjellje dhe veprime në përputhje me një tërësi parimesh e standardesh morale apo etike që zbatohen nga individët e institucionet dhe që pengojnë korrupsionin. Integriteti kombëtar mbahet dhe përfundon me një seri elementesh, të cilat janë pjesë e sistemit integruar kombëtar, siç janë elementet institucionale: gjyqësori, parlamenti, mediat e lira dhe të tjera si këto dhe elementet që përfaqësojnë veglat që një institucion duhet t'i ketë që të funksionoj.

Për të pasur një sistem të integritetit kombëtar stabil, duhet të plotësohen disa parakushte siç janë: mirëqenia e qytetarëve, cilësia e jetës, zbatimi i ligjit, dhe zhvillimi konstatnt (në vazhdimësi) i vendit. Është kryesore që këto kushte të plotësohen dhe të kemi një mirëfunksionim të shtetit ligjor dhe të së drejtës. Shteti i së drejtës, është krijuar që të qeveriset në mënyrë të drejtë dhe të ketë bazë të fortë të mirëfunksionimit, duke përfshirë kujdesin dhe vlerat e shoqërisë. Nëse kujdesi për shoqërinë është i lartë dhe vlerat janë të qëndrueshme, të dyja së bashku do të mbajnë elementet e sistemit të integritetit kombëtar, duke i'u shtuar forcë. Nga ana tjetër, nëse shoqëria nuk është e tillë këto baza do të jenë të dobëta dhe elementet e sistemit të integritetit kombëtar do të jenë bosh dhe të paefektshëm.

Nëse institucionet përkatëse juridike u nënshtrohen deformimeve, korrupsionit, nëse janë në shërbim të strukturave të caktuara politike ose të qendrave të fuqisë, padyshim shkaktohet dëmtimi dhe deformimi i sistemit juridik. Përgjegjësia e organeve të jurisprudence, korrupsioni i mundshëm, presionet që vijnë nga individët nga qendrat e caktuara të fuqisë, veprojnë në mënyrë nxitëse ndaj kriminalitetit dhe shtyjnë gjendjen e përgjithshme të përgjegjësisë, me ç'rast jurisprudenca bëhet indikator i rëndësishëm, madje edhe orientuese e gjendjes së përgjithshme në shoqëri. (*Anti-Corruption, n.d.*)

Ka elemente të ndryshme përreth ndër elementet integruese më të zakonshme të cilat ndikojnë shtetin e së drejtës, në këtë rast në luftimi dhe parandalimin e korrupsionit janë:

### 2.9.3 Organet vendore

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës
2. Presidenca e Republikës së Kosovës
3. Zyra e Kryeministrit të Kosovës

4. Gjykata Supreme e Kosovës
5. Këshilli Prokurorial i Kosovës
6. Prokurori i Shtetit
7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës
8. Policia e Kosovës
9. Doganat e Kosovës
10. Institucioni i Avokatit të Popullit

Si organ që merrt drejtëpërdrejt me luftimin e korrupsionit në Kosovë është edhe Agjencia kundër korrupsionit, për të cilën do flas pak më shumë.

#### 2.9.4 Agjencia Kundër Korrupsionit

Agjencia kundër Korrupsionit është organ i pavarur i themeluar me ligj. Agjencia është themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa është funksionalizuar më 12 shkurt 2007 dhe është përgjegjëse për zbatimin e politikës shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. Mandati dhe kompetencat e Agjencisë janë të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit.

Fushëveprimi i Agjencisë është i përqendruar në hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, hetimin dhe zbulimin e rasteve me natyrë të korrupsionit, përpjekjet për parandalimin e fenomenit të korrupsionit si dhe vetëdijesimin e publikut në hapat progresiv drejtë krijimit të një shoqërie ku sundon rendi dhe ligji.

Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, jo pajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik. (*Agjencia kundër korrupsionit, 2019*)



Agjencia i ka kushtuar vëmendje të veçantë angazhimit për avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat për mision kanë luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Megjithatë bashkëpunimi ndër institucional në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit vazhdon të mbetet një sfidë. Agjencia në veçanti ka bashkëpunuar me: KGJK, MAP, Kuvendin e Kosovës, PK, ZKM, KPI, KRPP, OSHP, MF, KQZ, MTI, MD, AKP, MFSK, ZPD, MMPH, KPK ,NJPMNP, MASHT, MSH, po ashtu dhe me shoqërinë civile dhe mediat, konkretisht me: KDI, KALLXO.COM, FOL, D +, GSJP, IKD, ÇOHU, etj. (*Agjencia kunder korrupsionit, 2018*)

### **Organizimi i mbrendshëm i AKK**

Agjencia ka të punësuar 40 zyrtarë, duke përfshirë Drejtorin e Agjencisë. Organizimi i brendshëm është i rregulluar me Rregulloren Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit. (*AKK, 2013*) Sipas kësaj Rregullore, Agjencia është e ndarë në këto departamente dhe divizione:

1. *Departamentin për Luftimin e Korrupsionit* ka të punësuar 11 zyrtarë dhe është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të hetimit paraprak të rasteve të dyshimit për korrupsion, analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, si dhe raportimin për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike.
2. *Departamentin për Parandalimin e Korrupsionit* ka të punësuar 15 zyrtarë dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë, mbikëqyrjen e dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe korrupsionit në tërësi.
3. *Divizionin për Punë të Përgjithshme dhe Financa* ka të punësuar 5 zyrtarë dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen për burimet materiale, ofrimin e shërbimeve administrative, menaxhimin e financave dhe buxhetit si dhe logjistikën e Agjencisë.
4. *Zyrën për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim* ka të punësuar 4 zyrtarë dhe është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe tekniko-administrative për personelin e Agjencisë.

Në kuadër të AKK-s, konform dispozitave ligjore të shërbimit civil, janë të themeluara: Komisioni Disiplinor dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. (*Agjencia kunder korrupsionit, 2018*)

## 2.10 Institucionet dhe Organizatat Ndërkombëtare

### Nëpër botë

1. ICAC, Hong Kong
2. Zyra e Hetimeve të Praktikave Korruptive, Singapore
3. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
4. Zyra e Kombeve të Bashkuara e Programit të Zhvillimit në Kosovë (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

### Në Evropë

1. Shërbimi Qendror për Parandalimin e Korrupsionit, Paris, Francë
2. Departamenti i Hetimeve të Brendshme, Hamburg, Gjermani
3. Zyra për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit, Riga, Letoni
4. Shërbimi i Hetimit Special, Vilnius, Lituani
5. Autoriteti Kombëtar Norvegjez për Hetimin dhe Ndërshkrimin e Krimit Ekonomik dhe Mjedisor, Oslo, Norvegji
6. Departamenti Qendror për Hetim dhe Ndërshkim, Lisbon, Portugali
7. Grupi i Shteteve kundër (GRECO)
8. Komiteti i Ekspertëve mbi zgjedhjen e masave Kundër Pastrimit të Parave (MONEYVAL)
9. Politika Kundër korrupsionit e Bashkimit Evropian
10. OLAF-Zyra Evropiane kundër mashtrimit
11. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)
12. Nisma e Paktit të Stabilitetit anti-korrupsion (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

### **Organizatat jo-qeveritare ndërkombëtare**

1. Transparenca Ndërkombëtare
2. Iniciativa U4
3. Koalicioni i Shoqërisë Civile Miqtë e UNCAC
4. TIRI
5. Projektit Ndërkombëtar i Buxhetit (IBP)
6. Organizata Globale e Parlamentarëve kundër Korrupsionit (GOPAC)
7. Global Dëshmitari (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

### **Mekanizmat e Interpol-it**

1. Akademia Kundër Korrupsionit e INTERPOL-IT
2. Grupi i Ekspertëve të INTERPOL-it kundër korrupsionit - (IGEC)
3. Grupi Ndërkombëtar për Koordinim e Anti-Korrupsionit (IGAC) (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

### **Organizatat ndërkombëtare**

1. Fondi Monetar Ndërkombëtar
2. Këshilli i Evropës
3. GRECO
4. MONEYVAL
5. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet
6. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
7. Iniciativa anti-korrupsion e Paktit të Stabilitetit, Zyra Rajonale në Sarajevo
8. Bashkimi Evropian
9. Banka Botërore
10. Task Forca e Veprimit Financiar (*Agjencia Kunder Korrupsionit, 2019*)

### 3. DEKLARIMI I RPOBLEMIT

Siç shihet nga të gjitha statistikat e paraqitura gjatë këtij punimi, Kosova ndër vite ka pasur rritje të veprave penale të kryera në formë të kriminalitetit të organizuar. Kjo nënkupton se përkundër angazhimit të organeve shtetërore dhe institucioneve të drejtësisë për trajtimin e kriminaliteti të organizuar, kjo dukuri ka vazhduar të rritet dhe shkaqet kryesore të cilat ndikojnë në mënyrë indirekte në paraqitjen dhe rritjen e kriminalitetit të organizuar konsiderohen faktorët ideopolitikë të kriminalitetit.

Korrupsioni është një ndër pengesat kryesore në rrugën e zhvillimit të qëndrueshm politik, ekonomik dhe shoqëror të një shteti. Në renditjen e indeksit global në lidhje me perceptimin e korrupsionit në vendet Evropës dhe të Ballkanit Perëndimor, Kosova renditet në një pozitë jo të favorshme. Prandaj, është në interes të Kosovës që të përmisojë imazhin e saj në luftën kundër korrupsionit.

Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është një obligim që rrjedh nga anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, e paraparë me Konventat e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, dhe standarteve tjera kundër korrupsionit. Përveç bazës ligjore, Parlamenti i Kosovës miraton cdo katër vite Strategjinë Kundër Korrupsionit si dhe Planin e Veprimit. Edhe pse korniza aktuale ligjore konsiderohet e mirë për të sjellë rezultate të prekshme në këtë fushë, megjithatë ekzistojnë çështje të cilat kërkojnë rregullimin edhe më të mirë në mënyrë që të parandalohet dhe të luftohet korrupsioni.

Përkundër progresit të arritur deri më tani, Kosova, sikurse edhe vendet e tjera të rajonit, vazhdon të përballlet me vështirësi në sektorin e Sundimit të Ligjit, përkatësisht me mangësi të theksuara në sistemin gjyqësor, çështje të brendshme dhe qasje në drejtësi.

Raportet e ndryshme ndërkombëtare dhe Raportet e Progresit për Kosovën si dhe dokumentet strategjike nacionale vënë në pah nevojën për përkushtimin shtetëror proaktiv në përmirësimin e efikasitetit të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit në përgjithësi, e vecanërisht në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Edhe pse, në përgjithësi, Kosova ka elemente të mjaftueshme të vendosura në kornizën ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, sikurse që ka edhe institucione përkatëse, në aspektin praktik lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të të gjitha llojeve vazhdon të mbetet sfida për autoritetet r Kosovës. Kjo çështje duhet të shikohet nga dy aspekte, sa i përket luftimit të brendshëm institucional kërkohet forcimi i mekanizmave të brendshëm të institucioneve përkatëse.

## 4. METODOLGJIA

Për realizimin e këtij punimi, kam aplikuar metoda bashkëkohore që zbatohen në shkencë shoqërore. Natyra e ndjeshme dhe delikate e parandalimit dhe luftimit të fenomenit të korrupsionit, domosdoshmërisht kërkon që të zbatohen edhe metoda të ndryshme shkencore në trajtimin e kësaj dukurie. Qasja metodologjike në këtë punim është fokusuar në aplikimin e këtyre metodave:

Metoda historike – domosdo, që gjatë kërkimit dhe hulumtimit shkencor për një fenomen duhet të fokusohemi dhe t'i kushtojmë rëndësi metodës historike nëpërmjet të cilës do të shqyrtohet dhe pasqyrohet ekzistenca dhe evoluimi i korrupsionit në aspektin historik, format dhe mënyrat e paraqitjes në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë.

Metoda e analizës teorike - duke analizuar Korrupsionin, si veprë penale me të gjitha tiparet dhe format e paraqitura, duke konsultuar literaturë profesionale dhe duke dhënë konkluzione lidhur me të.

Metoda përshkruese – përmes së cilës janë përshkruar karakteristikat e përgjithshme të të shfaqjes së korrupsionit me theks të veçantë në Kosovën. Objekti i studimit është objekt relativisht i gjerë. Kjo metodë është përdorur me qëllim dhënien e përkufizimit juridik të korrupsionit sipas legjislacioneve apo akteve ndërkombëtare, si dhe për të përshkruar para analizës, parashikime të legjislacionit të brendshëm.

Metoda statistikore - përmes së cilës do të paraqiten të dhënat zyrtare për veprat penale të kryera me korrupsion, të paraparë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit të trajtuara nga gjykatat themelore në tërë Kosovën, gjykata e Apelit dhe Supreme të Kosovës.

## **5. PREZANTIM DHE ANALIZA E REZULTATEVE**

Përkundër punës që është bërë ndër vite si në aspektin e pasurimit të kornizës ligjore dhe krijimin e institucioneve përkatëse për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, ende ka nevojë për shtim dhe përmisime pasi rezultatet e statistikave na tregojnë që Kosova nuk qëndron mirë me luftimin e këtij fenomeni. Sipas raportit që paraqet dokumentin e parë të përgatitur nga Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore me qëllim të monitorimit të trendeve në politikën ndëshkimore në Kosovë dhe ka për qëllim, të jap një pasqyrim të përgjithshëm bazuar në vendimet e marra gjatë vitit 2018 nga gjykatat e të gjitha instancave në veprat që ndërlidhen me korrupsion.

Në këtë kapitull kam vendosur ti paraqesë statistikën të dalura nga Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore, që është pasqyrim i përgjithshëm i trajtimit të lëndëve të korrupsionit 2018.

Tabela e mëposhtme paraqet një pasqyrim të përgjithshëm vetëm mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit të trajtuara nga gjykatat themelore në tërë Kosovën. Tabela nuk përmban detaje të lartësisë së dënimit. Kjo për faktin se Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore është themeluar nga mesi i vitit 2018 dhe nuk ka pasur në dispozicion mekanizmat për të përcjellë vendimmarrjen nga ana e gjykatave. (Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore, 2019)

Tabela 1. Përfshin statistikat nga Gjykatat Themelore për vitin 2018 për trajtimin e rasteve të korrupsionit

2018	Nr. i lëndëve të zgjidhura	Aktgjykim me burgim	Dënim me gjobë	Dënim Alternativ	Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Pushim i procedurës
Prishtinë	86	10	14	18	20	8	16
Ferizaj	8	1		4	2	1	
Prizren	24	5	4	6	6	1	2
Gjakovë	20	1	3	4	5	1	6
Gjilan	40	4	5	4	22	2	3
Mitrovicë	10		5	1	3	1	
Pejë	16	1	2	3	5	2	3
<b>gjithsejt</b>	<b>204</b>	<b>22</b>	<b>33</b>	<b>40</b>	<b>63</b>	<b>16</b>	<b>30</b>

Tabela 2. Përfshin statistikat nga Gjykata e Apelit për vitin 2018 për trajtimin e rasteve të korrupsionit

NENI	Hudhje e ankesës	Vendimi i shkallës së parë:				
		Është vërtetuar	Është abroguar	Ashpërsim i dënimit	Zbutje e dënimit	Ndryshuar për arsye tjera
	<b>2</b>	<b>69</b>	<b>23</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>9</b>
422/339	2	47	16	0	0	6
423	0	2	0	0	0	0
424	0	1	0	0	0	0
425/340	0	3	4	0	0	0
426/341	0	2	1	0	0	1
428/343	0	7	1	1	2	1
429/344	0	3	0	0	0	1
431/345	0	1	0	0	1	0
432/346	0	1	0	0	0	0
433/347	0	1	0	0	0	0
434/348	0	1	1	0	0	0



Tabela 3. Përfshin statistikat nga Gjykata e Supreme për vitin 2018 për trajtimin e rasteve të korrupsionit

<b>Raport vjetor për lëndët e korrupsionit për periudhën 01.01.2018-31.12.2018</b>	<b>Të aprovuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Të hedhura poshtë</b>	<b>Gjithesëj</b>
	7	10	3	20

## 6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Korrupsioni në shoqërinë tonë nuk është diçka e re, ai ka ekzistuar, ekziston dhe do të vazhdojë të ekzistoj, por qëllimi është se si ta reduktojmë atë. Arritja e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit varet në masë të madhe nga të kuptuarit e korrupsionit nga qytetarët dhe gatishmëria e tyre për të marrë pjesë në këto aktivitete. Në vendet me traditë demokratike, ku sundimi i ligjit ka një nivel të lartë, korrupsioni është dukuri e kontrolluar, por jo e eliminuar.

Zvogëlimi i nivelit të korrupsionit nuk është një proces i lehtë, madje as edhe i shpejtë në kohë. Ai lidhet me faktorë të shumtë historikë, ekonomikë e politikë të cilët veprojnë në shkallë, intensitete e forma të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Korrupsioni sot është një dukuri që është prezente në çdo shoqëri pa përjashtim, por në një nivel shumë me të lartë në vendet më pak të zhvilluara, ku korrupsioni paraqet sfidën kryesore korrupsioni mbetet problem i madh për vendet e Evropës Juglindore. Shtetet e Ballkanit radhiten diku ka mesi i listës botërore së shteteve sa i përket korrupsionit. Korniza ligjore kundër korrupsionit në Kosovë është mjaft e konsoliduar, megjithatë sfida mbetet parandalimi dhe zbatimi efektiv i saj.

Efektet që ka korrupsioni në një vend shtrembëron keq realitetin politik, duke sjellë shkatërrim në sistemin elektorale, administrativ, institucional e në të gjithë mekanizmat që mbajnë një shtet në lëvizje. Korrupsioni prodhon varfëri dhe rënie të përgjithshme ekonomike e shoqëruar me pakënaqësi shoqërore ndaj reformave për zhvillimet demokratike, sjell uljen e efektivitetit të funksionimit të pushtetit shtetëror dhe minimizimin e besimit të qytetarëve te organet e shërbimit publik shtetëror. Korrupsioni është prezent në Kosovë por nuk përputhet me perceptcionin. Përgjegjësinë për korrupsion nuk duhet t'a mbajnë vetëm të korruptuarit por edhe ata që i korruptojnë të tjerët dhe ata që nuk e raportojnë korrupsionin.

Kosova ka AKK, Agjencia kundër Korrupsion që është institucion i pavarur i themeluar në korrik të vitit 2006, e cila për te realizuar me sukses misionin e saj duhet të jetë: e pavarur, profesionale, me strukturë të profilizuar, e hapur për bashkëpunim, transparente dhe mirë e paguar. Por, nëse nuk ka një bashkëpunim ndërmjet të gjitha institucioneve të thirrura për parandalimin, hetimin, gjykimin dhe luftimin e korrupsionit është shumë e vështirë të luftohet ky fenomen.

Korrupsioni nuk është vetëm një çështje e brendshme e shteteve të veçanta që kanë probleme me korrupsion, por ai është pjesë e interesit ndërkombëtar. si detyra të përhershme të bashkëpunimit ndërkombëtar në sferën juridike rekomandohen :

- Afrimi i legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar, sidomos atë që rregullon praninë e shtetit në ekonomi;
- Vazhdimin e procesit të aderimit, ratifikimit dhe nënshkrimit të instrumenteve ndërkombëtare në fushën penale.
- Zgjerimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor me vendet e tjera nëpërmjet marrëveshjeve dy dhe shumëpalëshe.
- Krijimin e sistemit të rrjetit gjyqësor midis institucioneve vendëse dhe të huaja në fushën e çështjeve juridike dhe penale.
- Bashkëpunimin në fushën e dorëzimit të kriminelëve dhe ekstradimit të tyre.
- Bashkëpunimin në transferimin e ndjekjes penale në çështje penale.
- Bashkëpunimin për transferimet e personave të dënuar.
- Njohjen dhe aderimin në marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet ndërkombëtare në këto fusha.
- Bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet e krimeve financiare dhe të pastrimit të parave, ku të përfshihen bashkëpunimi përkatës i institucionalizuar ndërmjet partnerëve ndërkombëtarë dhe Policisë së Shtetit, policia gjyqësore, policia financiare, prokuroria si dhe njësitë e shërbimit sekret etj.
- Bërjen e marrëveshjeve bilaterale me shtete që kanë shkëmbime ekonomike për të rregulluar marrëdhëniet në këtë fushë.

Çrrënjësja e korrupsionit në Kosovë do duhet të përfshijë jo vetëm reformat institucionale dhe legjislative, por gjithashtu edhe një angazhim afatgjatë nga ana e qeverisë për të ndryshuar kulturën ndaj korrupsionit në Kosovë. Përafrimet e shumë akterëve që kanë role dhe përgjegjësi në vend në luftimin e korrupsionit dhe sidomos, rëndësia e përfshirjes aktive e shoqërisë civile dhe medias, janë tashmë përgjithësisht të pranuar si thelbësore për çfarëdo program të suksesshëm reforme

kundër korrupsion. Kosova duhet ndërtoj kornizë ligjore të mirëfilltë, serioze dhe efektive kundër korrupsionit, pra përveç ligjeve ekzistuese, të nxjerrë edhe ligje të reja që kanë qëllim luftimin e korrupsionit, të rritet transparenca që të rikthehet përsëri besimi i qytetarëve tek institucionet shtetërore. Të bashkëpunoj që sa më parë të synoj antarsimin në grupin e shteteve kundër korrupsionit duke harmonizuar legjislacionin vendor me atë ndërkombëtar, ngase Evropa ka dyer të hapura për vende serioze dhe të sigurta, ndërsa mbron kufijtë e saj nga vendet problematike.

## 7. REFERENCAT

55/25, G. A. r., 2000. *United Nations Office on Drugs and Crime*. [Në linjë]

Available at:

<https://www.unodc.org/documents/treaties/UNTOC/Publications/TOC%20Convention/TOCebook-e.pdf>

Agjencia kunder korrupsionit, R. V. I. P. 2. - A., 2018. *RAPORTI VJETOR I PUNËS 2018 - AKK*, s.l.: s.n.

Agjencia Kunder Korrupsionit, R. V. i. P.-2., 2019. *akk-ks.org*. [Në linjë]

Available at: [https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20SHQ%20-%20Raporti%20Vjetor%20Final%2028%20Mars%202019%20\(BD\).pdf](https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/01.%20SHQ%20-%20Raporti%20Vjetor%20Final%2028%20Mars%202019%20(BD).pdf)

Agjencia kunder korrupsionit, S. k. k. 2.-2., 2013. *akk-ks.org*. [Në linjë]

Available at: [https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Stragjia\\_2013\(1\)\\_418966.pdf](https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Stragjia_2013(1)_418966.pdf)

Agjencia Kunder Korrupsionit, S. s. k. k. 2.-2., 2019. *Agjencia Kunder Korrupsionit*. [Në linjë]

Available at: <https://akk-ks.org/ballina>

Agjencia kunder korrupsionit, S. s. k. k. 2.-2., 2019. *akk-ks.org*. [Në linjë].

AKK, R. p. o. e. b. d. s. e. v. t. n., 2013. *akk-ks.org*. [Në linjë]

Available at: <https://akk->

[ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Legjislacioni%20vendas/Rregullore\\_nr\\_01-2013\\_\(1\).pdf](https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Legjislacioni%20vendas/Rregullore_nr_01-2013_(1).pdf)

Anon., 2005. *Council of Europe*. [Në linjë]

Available at:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168007bd23>

Anon., 2013. *Kuvendikosoves.org*. [Në linjë]

Available at: <http://www.kuvendikosoves.org/>

Anti-Corruption, T. I. t. G., a.d. *transparency.org*. [Në linjë]

Available at: <https://www.transparency.org/glossary/term/corruption>

Assembly, G., 1949. *European Commission*. [Në linjë]

Available at: <https://ec.europa.eu/anti->

[trafficking/sites/antitrafficking/files/un\\_convention\\_for\\_the\\_suppression\\_of\\_the\\_traffic\\_in\\_persons\\_1949\\_en\\_1.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/un_convention_for_the_suppression_of_the_traffic_in_persons_1949_en_1.pdf)

Assembly, G., 1949. *European Commission*. [Në linjë]

Available at: <https://ec.europa.eu/anti->

[trafficking/sites/antitrafficking/files/un\\_convention\\_for\\_the\\_suppression\\_of\\_the\\_traffic\\_in\\_persons\\_1949\\_en\\_1.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/un_convention_for_the_suppression_of_the_traffic_in_persons_1949_en_1.pdf)

Assembly, G., 1988. *United Nations Office on Drugs and Crime*. [Në linjë]

Available at: [https://www.unodc.org/pdf/convention\\_1988\\_en.pdf](https://www.unodc.org/pdf/convention_1988_en.pdf)

Assembly, G., 2001. *treaties.un.org*. [Në linjë]

Available at: [https://treaties.un.org/doc/source/RecentTexts/18-12\\_c\\_E.pdf](https://treaties.un.org/doc/source/RecentTexts/18-12_c_E.pdf)

Beka, P. a. d. A., 2015. *Krimi i organizuar ne urbanizem dhe qarkullim te pasurive te paluajtshme*. Prishtine: s.n.

Brooks, J., 2019. *Vleresimi i Rrezikut per Oden e Notereve te Kosoves*. s.l.:s.n.

Commission, E., 2016. *European Commission*. [Në linjë]

Available at: [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/corruption\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/corruption_en)

Community, E., 2005. *Council of Europe*. [Në linjë]

Available at: <https://rm.coe.int/168008371f>

Europe, C. o., 2016. *Council of Europe*. [Në linjë]

Available at: <https://www.coe.int/en/web/greco/about-us/background>

Europe, C. o. M. o. t. C. o., 2005. *Council of Europe*. [Në linjë]

Available at:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168008371d>

Gashi, D. R., 2014. *Krimi i Organizuar*. Prishtine: s.n.

Halili, D. R., 2016. *Kriminologjia*. Prishtine: s.n.

Hasani, P. D. I. S. M. H. Z. F., 2014. *Komentari i Kodit Penal te Republikes se Kosoves*. s.l.:s.n.

Hysi, V., 2000. *Hyrje ne Kriminologji dhe Penologji*. Tirane: s.n.

Hysi, V., 2005. *Kriminologjia*. Tirane: s.n.

International-Kosova, T., 2018. *kallxo.com*. [Në linjë]

Available at: <https://kallxo.com/gjate/analize/transparency-international-kosova-shenon-regres-ne-luften-kunder-korrupsionit/>

Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore, A. e. D., 2019. *rks-gov.net*. [Në linjë]

Available at: [https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/GjskSq19\\_.pdf](https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/GjskSq19_.pdf)

Konventa Civile kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës (Nr.174, 1., 1999. *akk-ks.org*. [Në linjë]

Available at: <https://akk->

[ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Instrumentet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/174\(1\).pdf](https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Instrumentet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/174(1).pdf)

Konventa e Kombeve të Bashkura kundër Korrupsionit (58/4, 2., 2003. *akk-ks.org*. [Në linjë]

Available at: <https://akk->

[ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Instrumentet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/Convention-e\(1\).pdf](https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Instrumentet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/Convention-e(1).pdf)

Konventa Penale e Korrupsionit e Këshillit të Evropës (Nr. 173, 1., 1999. *akk-ks.org*. [Në linjë]  
 Available at: [https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Instrumentet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/173\(1\).pdf](https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Instrumentet%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/173(1).pdf)

Kosoves, K. i., 2010. *Gazeta Zyrtare e RKS*. [Në linjë]  
 Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662>

Kosoves, K. i., 2011. *Gazeta Zyrtare e RKS*. [Në linjë]  
 Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

Kosoves, K. i., 2018. *Gazeta Zyrtare e RKS*. [Në linjë]  
 Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2768>

Kuvendi i Republike se Kosoves, K. i. P. P., 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosoves*. [Në linjë]  
 Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

Kuvendi i Republikës së Kosoves, K. P. i. K., 2019. *Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosoves*. [Në linjë]  
 Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

Kuvendi i Republikës se Kosoves, L. p. A. k. k., 2010. *rks-gov.net*. [Në linjë]  
 Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662>

Kuvendi i Kosoves, K. i. P. P. i. K., 2003. *Gazeta Zyrtare*. [Në linjë]  
 Available at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8674>

Lascoumes, P., 2002. *Korrupsioni (perkthim)*. Tirane: s.n.

Latifi, P. d. V., 2013. *Politika Kriminale*. Prishtine: s.n.

Latifi, P. d. V., 2014. *Kriminalistika, Zbulimi dhe te provuarit e krimit*. Prishtine: s.n.

Nations, U., 1998. *United Nations Human Rights*. [Në linjë]  
 Available at: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/protocoltraffickinginpersons.aspx>

Nations, U., 2000. *United Nations Office on Drugs and Crime*. [Në linjë]  
 Available at: [https://www.unodc.org/documents/middleeastandnorthafrica/smuggling-migrants/SOM\\_Protocol\\_English.pdf](https://www.unodc.org/documents/middleeastandnorthafrica/smuggling-migrants/SOM_Protocol_English.pdf)

PACE, a.d. *PACE*. [Në linjë]  
 Available at: <http://assembly.coe.int/nw/Home-EN.asp>

Parliamentary Assembly, C. o. E.-P., 2016. *Assembly.coe*. [Në linjë]  
 Available at: <http://www.assembly.coe.int/nw/Home-EN.asp>

Qeveria/Ministria e Puneve te Brendshme, S. k. k. d. p. i. v., 2019. *kryeministri-ks.net*. [Në linjë]  
 Available at: <https://kryeministri-ks.net/documents/strategjia-shteterore-kunder-krimit-te-organizuar-dhe-plani-i-veprimit-2018-2022/>

Salihu, D. I., 2014. *E drejta Penale, Pjesa e posacme*. Prishtine: Kolegji Fama.

Susuri, T. I. (. E. e. L. G. L., 2019. *evropaelire.org*. [Në linjë]

Available at: <https://www.evropaelire.org/a/kosova-kthim-prapa-ne-luften-kunder-korrupsionit/29736661.html>